

SKEMA E MBËSHTETJES ME GRANTE KOMUNITARE

1. HYRJE

Programi “Grante për Komunitetin” i Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit (FMB) do të mbështesë komunitetin e lidhur me Parkun Kombëtar të Butrintit nëpërmjet Skemës së Granteve për Komunitetin (SGK), financimi i së cilës mundësohet nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Programi zbatohet në përputhje me objektivat dhe prioritetet e Planit të Menaxhimit të Integruar të Butrintit dhe Planit të Zhvillimit të Komunitetit, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit lokal dhe në rritjen e përfitimeve që komuniteti merr nga trashëgimia kulturore dhe natyrore e Butrintit.

Qëllimi i skemës është të nxisë përfshirjen e komunitetit në aktivitete ekonomike, kulturore dhe sipërmarrëse të lidhura me Parkun, të mbështesë përmirësimin dhe zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese, të forcojë qëndrueshmërinë financiare të tyre, si dhe të promovojë diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Në përputhje me politikat e saj, FMB me fonde të siguruara nga AADF, do të organizojë procesin e kësaj skeme. Skema do të jetë bashkëfinancuese, ku nëpërmjet SGK ofrohet një vlerë monetare në formë granti e cila i “bashkohet” kontributit financiar që do të investohet nga vetë aplikuesi, sipas angazhimit të tij/saj në procesin e aplikimit. SGK është një program konkurrues. Dorëzimi i aplikimit nuk krijon të drejtë automatike për financim. AADF rezervon të drejtën të mos financojë asnjë aplikim nëse nuk përmbush standardet minimale të cilësisë dhe ndikimit.

2. PRANUESHMËRIA

Pranueshmëria e aplikimeve për tu përfshirë në SGK do të vlerësohet në bazë të:

- Vendndodhja e aplikuesit në territorin e Parkut kombëtar;
- Kategoritë e aplikuesve;
- Llojet e aktiviteteve/shërbimeve të pranueshme;
- Llojet e investimeve të pranueshme;
- Buxhetet dhe ndarja e kostove ndërmjet SGK dhe aplikuesit;
- Objektivat dhe rezultatet do të jenë të qarta dhe të arritshme.

Vetëm aplikimet të cilat kontribuojnë në nxitjen/përfshirjen e komunitetit në aspektet e larmshmërisë së ofertës së aktiviteteve/shërbimeve apo të përmirësimeve të atyre ekzistuese dhe të cilat janë në linjë me objektivat e shpallura të Planit të Menaxhimit të Parkut të Butrintit, do të konsiderohen për mbështetje.

Kriteret e përjashtimit

Aplikimet dhe/ose aplikuesit nuk do të konsiderohen të pranueshëm nëse:

- aplikuesi, përfaqësuesit ligjorë ose personat e lidhur me të kanë konflikt interesi me FMB, AADF ose anëtarët e Komisionit të Granteve;
- aplikuesi ka detyrime të papaguara tatimore ose detyrime të tjera ligjore të pashlyera;
- aplikuesi ose përfaqësuesit e tij janë dënuar me vendim të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, pastrim parash ose vepra të tjera penale që lidhen me integritetin financiar;
- aplikimi përmban informacion të pasaktë, të rremë ose të paplotë që ndikon në vlerësimin e pranueshmërisë dhe/ose cilësisë së aplikimit.

3. KUSH MUND TË APLIKOJË

Programi i mbështetjes nëpërmjet SGK do të marrë në konsideratë aplikimet nga:

3.1 Aplikues me vendndodhje në:

Komunitetet e Vrinës, Shëndëllisë, Xarrës, Çiflikut, Mursisë dhe zonat e tjera rurale të lidhura me Parkun Kombëtar të Butrintit, të identifikuar në Planin e Zhvillimit të Komunitetit si zona prioritare për zhvillim ekonomik, social dhe turistik.

3.2 Aplikues subjekte të rregjistruar biznes:

- a. Biznese të vogla artizanale;
- b. Biznese që ushtrojnë aktivitetin e tyre në bujqësi, blegtori, bimë mjekësore, aquakulturë, etj. të ngjashme;
- c. Biznese në prodhim/tregti dhe shërbime të produkteve ushqimore dhe produkteve të përpunuara ushqimore, me origjinë lokale/shqiptare;
- d. Biznese në shërbime akomodimi (B&B), gastronomie tradicionale;
- f. Biznese me tematike kulturore, tregti dhe shërbime (galeri arti, antikuare, koleksionues, artist lokal, etj);
- g. Aktivitete të tjera që demonstrojnë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat e Planit të Menaxhimit të Butrintit.

3.3 Aplikues Individë (të cilët pas shpalljes fitues të aplikimit duhet të rregjistrohen të paktën si biznes i vogël)

- a. Individë me profil artizanal (peshkatar, prodhues artikujsh artizanal, etj)
- b. Individë që ushtrojnë veprimtari si guidë turistike;
- c. Individë që ofrojnë ambiente/shtëpitë e tyre si B&B;
- d. Individë me profil në fushat e artit që ushtrojnë aktivitete në territorin e Parkut;

3.4 Aplikues OJF

OJF ekzistuese apo që krijohen në territorin e Parkut aplikojnë për mbështetje financiare për aktivitete promociionale, kulturore, të nxitjes, të përfshirjes, të trajnimit, të përfaqësimit, etj. Mund të aplikojnë për mbështetje financiare të aktiviteteve të mësipërme edhe organizata me seli brenda qarkut, me kushtin që aktiviteti i propozuar duhet të ndodhë brenda territorit të Parkut dhe përfituesit duhet të jenë nga komuniteti i Parkut.

4. INVESTIMET QË MBËSHTETEN

Bashkëfinancimi mund të përdoret për secilin nga artikujt e listuar më poshtë:

- a. Makineri dhe pajisje (të tilla si frigoriferë, lavanderi, vegla artizanati, peshkimi, varka pa motor, çadra dhe pajisje plazhi, sinjalistikë ujore, pajisje të sinjalizimit, kujdesit dhe ndihmës së shpejtë, etj);
- b. Blerje mobiljesh (të tilla si tavolina, karrige, dollap, etj);
- c. Pajisje ndriçimi të jashtme, tabela orientuese (në përputhje me rregulloret dhe Planin e Menaxhimit të Butrintit);
- d. Përmirësim të gjelbërimit natyror/të shtigjeve natyrore, mbjellje bimësh dekorative të kontekstit lokal;
- e. Investime rikonstruksioni/restaurimi të ambjenteve të brendshme/të jashtme me lejet përkatëse;
- f. Aktivitete kulturore, promociionale, nxitëse, përfshirëse, trajnuese, përfaqësuese;
- g. Mbështetje pagesë qiraje për bizneset e artizanatit dhe bizneset me tematikë kulturore;
- h. Investime ose aktivitete të tjera që demonstrojnë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat e Planit të Menaxhimit të Butrintit.

Investimet dhe shpenzimet e papranueshme

Nuk janë të pranueshme për financim: aktivitete politike ose fetare; blerje toke ose ndërtesash; blerje automjesh; paga dhe shpërblime të personelit; interesa kredie, gjoba ose penalitete; shpenzime operative të zakonshme; si dhe çdo shpenzim tjetër që nuk lidhet drejtpërdrejt me objektivat e Skemës së Granteve Komunitare.

5. LIMITET E BASHKËFINANCIMIT

Shumat potenciale të bashkëfinancimeve, bazuar në diapazonet e investimeve për secilin aplikues, do të jenë sipas tabelës vijuese:

Investimi i parashikuar	Shuma maksimale e grantit	% ndaj investimit
<20,000 \$	10,000 \$	80-50%
20,001\$-30,000\$	12,000 \$	60% - 40%
30,001\$-50,000\$	15,000 \$	50% - 30%
50,001\$-100,000\$	20,000 \$	40% - 20%
Mbështetja për qira vjetore		
Buxheti i parashikuar për qira vjetore	Shuma maksimale e mbështetjes për qira vjetore	% ndaj qirasë vjetore
<10,000 \$	<5,000 \$	50%
Mbështetja për OJF		
Buxheti i parashikuar për aktivitet	Shuma maksimale e mbështetjes për aktivitet	Bashkëfinancim in kind ose nga donatorë të tjerë ose nga përfituesit e drejtëpërdrejtë
<10,000 \$	<8,000 \$	>2,000 \$

Një aplikues nuk mund të përfitojë më shumë se një grant brenda të njëjtës thirrje. Çdo kufi maksimal total i financimit për periudhën e programit do të përcaktohet në dokumentet e thirrjes dhe/ose në marrëveshjen e grantit.

6. KUSHTËZIME TË FINANCIMIT

a. Në mënyrë që aplikuesi të fitojë të drejtën e përfitimit të grantit, aplikuesi duhet të mbulojë me fondet e veta një pjesë të kostos së investimit dhe ta vërtetojë këtë kontribut financiar. Përfituesit pritët të pëmbushin të gjitha angazhimet e marra lidhur me ndarjen e kostove.

b. Aplikuesi duhet të garantojë që investimi në makineri/pajisje/mobilje etj të ngjashme nuk do të ndryshojë destinacion, të jepen në përdorim apo dhurohen në persona/subjekte të tretë, të paktën për një periudhë tre vjeçare. Një marrëveshje përkatëse do të firmoset përpara përfitimit të investimit me aplikuesin fitues.

c. Investimet në natyrë fizike në një objekt (rikonstruksionet, restaurimet, etj) duhet të jenë në objekte në pronësi të aplikuesit, nëse objekti do jetë i marrë me qira (jo më pak se 3 vjet) nga aplikuesi, pronari/ët e objektit duhet të përfshihen në dakordësi paraprake që në momentin e aplikimit dhe pastaj në marrëveshjen e bashkëfinancimit.

d. Aplikuesi për mbështetje për qira, duhet të kenë një kontratë qiramarrje të noterizuar për një afat jo më pak se 3 vjet.

- e. Aplikuesi për aktivitete duhet të mbajë parasysh që financimet për zhvillimin e aktiviteteve do të bëhen pas realizimit të aktivitetit/eve për të cilin/at është aplikuar dhe fituar.
- f. Aplikuesit fitues do të nënshkruajnë, pas aprovimit të aplikimit, një marrëveshje tre-palëshe bashkëfinancimi ndërmjet FMB, AADF dhe përfituesit.
- g. Pagesa e grantit do të kryhet në formë rimbursimi, mbi bazën e faturave, kontratave dhe provave të pagesës të dorëzuara nga përfituesi dhe të verifikuara nga Komisioni i Granteve.
- h. AADF dhe/ose FMB kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e plotë ose të pjesshëm të grantit nëse, brenda 3 (tre) viteve nga përfundimi i financimit, identifikohen deklarime të pavërteta, përdorim i fondeve në kundërshtim me marrëveshjen ose shkelje të kushteve të financimit.
- i. Aplikuesi duhet të deklarojë çdo marrëdhënie familjare, financiare apo profesionale me stafin e FMB, AADF ose anëtarët e Komisionit të Granteve. Çdo konflikt interesi i padeklaruar ose çdo tentativë për të ndikuar procesin e vlerësimit sjell skualifikim të menjëhershëm.
- j. Informacioni i pasaktë, i paplotë ose i rremë në aplikim sjell refuzimin e aplikimit, ndërprerjen e financimit dhe/ose kërkesën për kthimin e fondeve të disbursuara.
- k. AADF dhe/ose FMB mund të kontrollojnë dokumentacionin financiar dhe teknik të grantit deri në 3 (tre) vite pas përfundimit të grantit. Përfituesi është i detyruar të ruajë dokumentacionin përkatës dhe ta vendosë në dispozicion kur kërkohet.

7. PROCESI I APLIKIMIT

7.1 Shpallja e thirrjeve:

- a) Thirrja nr.1 për aplikim në SGK shpallet në 16 Korrik, me afate të përcaktuara për dorëzimin e aplikimeve;
- b) Thirrje shtesë, mund të ketë në periudha ndërmjetëse, në raste të justifikuara, bazuar në:
- disponueshmërinë e fondeve;
 - prioritetet e programit;
 - nivelin e kërkesës nga komuniteti.

7.2 Paketa e aplikimit

Dosja e aplikimit për SGK do të jetë për e vecantë për:

- a) Paketa të vecanta për individët;
- b) Paketa të vecanta për bizneset;
- c) Paketë e vecantë për OJF;

7.3 Aplikimi

- a) Aplikuesi plotëson me informacionin e nevojshëm “Paketën e Aplikimit të Grantit”;
- b) Paketa e plotë e aplikimit dorëzohet fizikisht pranë FMB.

7.4 Procesi i vlerësimit

- a) Verifikimi administrativ, i kryer nga FMB, për kontrollin e plotësisë dhe përputhshmërisë së aplikimit;
- b) Vlerësimi teknik dhe financiar, i kryer nga Komisioni i Granteve (i përbashkët FMB - AADF), i cili shqyrton aplikimet dhe harton listën e aplikuesve të rekomanduar për financim. Lista e aplikuesve të rekomanduar dërgohet për aprovim përfundimtar pranë AADF;

Në çdo rast, AADF rezervon të drejtën të kryejë inspektime dhe vlerësime të pavarura në terren, në ambientet ku do të realizohet investimi, përmes stafit të saj ose palëve të treta të kontraktuara.

7.5 Njoftimi i aplikuesve fitues

- a) Pas miratimit, FMB njofton zyrtarisht aplikuesit fitues dhe jo-fitues.
- b) Pas njoftimit, nënshkruhet një marrëveshje tre-palëshe ndërmjet përfituesit, FMB dhe AADF, e cila përfshin:
 - përshkrimin e investimit;
 - vlerën e grantit;
 - listën e inventarit të financuar;
 - afatet dhe detyrimet e palëve;
 - etj.

8. TË VEÇANTA

- a) Afatet e procesit të aplikimit dhe të aprovimit, së bashku me listën e aplikuesve fitues dhe vlerat përkatëse do të jenë të afishuara në faqen web të FMB dhe të AADF;
- b) Aplikuesit do të plotësojnë paketën e aplikimit në të gjithë elementët e saj sipas udhëzimeve që do të jenë pjesë e paketës së aplikimit;
- c) Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacion të vlefshëm, leje, kontrata parablerje, fatura, mandate të pagesave të kryera, dokumentacion të inventarit si dhe çdo dokumentacion tjetër justifikues në funksion të investimit/aktivitetit të kryer, shërbimit të marrë etj;
- d) Aplikuesit individë pas shpalljes fitues të aplikimit duhet të regjistrohen të paktën si biznes i vogël; dokumentacioni i nevojshëm për tu paraqitur në origjinal ose në kopje të noterizuara l njoftohet aplikuesit nga komisioni pas shpalljes fitues të grantit;
- e) Tjetër.

Pyetjet dërgohen në adresën e-mail: info@bmf.al ose në whatsapp në numrin: +355 69 702 7379